ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër : **N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **TU-25-215-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Sigurimi i autobusëve dhe veturave zyrtare**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

KOMPANIA E SIGURIMEVE "DUKAGJINI"SH.A.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

XHEVDET DODA OBJ.DUKAGJINI RESIDENCE HY.A1 K.1
(Adresa)

PRISHTINË — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

+383 49 770 981 — *XXX*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

VALMIR GASHI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

valmir.gashi@dukagjiniks.com
(Adresa elektronike)

24.03.2025 — _____
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05-Njoftimi per kontrat: 21.01.2025 00:00
B12 - Proces verbali i hapjes se Tenderve: 10.02.2025
B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues 13.03.2025
Kërkesë për rishqyrtim : 18.03.2025
Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim 19.03.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. Ligji Nr. 04/L-042 Për prokurimin publik në Republiken e Kosoves

2. Rregullat dhe Udhezuesi Operativ per Prokurimin Publik

3. Rregullorja 001/2022 për Prokurim Publik, e plotësuar dhe ndryshuar me rregulloren Nr.002/2024

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Drejtuar

ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Rr. "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës, Kati V-të), Prishtinë

Nga

K.S. DUKAGJINI SH.A.

Rr. XHEVDET DODA OBJ. DUKAGJINI RESIDENCE HY. A1 K.1

Datë: 24.03.2025

Në respektim, Bazuar në Nenin 108/A (Zgjidhja Preliminare e mosmarrveshjeve), dhe bazuar në nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092,

Operatori Ekonomik K.S. DUKAGJINI SH.A. (tani e tutje "Ankuesi"), lidhur me tenderin me numër prokurimi: TU-25-215-2-2-1 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : Sigurimi i autobusëve dhe veturave zyrtare, pasi ka shjterrur të gjitha afatet ligjor paraqet këtë:

ANKESË

Kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues N.P.K.TRAFIKU URBAN SH.A në Kërkesën për rishqyrtim të datës: 19.03.2025, për shkak të shkeljes së dispozitave Ligjore të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, Rregullave dhe Udhezuesit Operativ per Prokurimin Publik, shkeljes së Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik Rregullore, e ndryshuar dhe plotesuar me rregulloren Nr.002/2024 per prokurim publik. Andaj mbi bazën e arsyetimit të dhënë më poshtë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, që në përputhje me me dispozitat e LPP dhe Rregulloren e Punës të LPP-së, të aprovojë ankesën tonë si të bazuar ligjërisht, pra të anulon Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues të datës 13.03.2025 pasi ka shpallë fitues OE i cili është në kundershtim me Ligjet e aplikueshme dhe të na shpallë neve si operator ekonomik fitues pasi kemi ofertuar sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues, njëherit duke respektuar të gjitha Ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Kosovë. Shkeljet e bëra nga AK dhe OE janë:

Ligji Prokurimit Publik:

- ***Shkelje e nenit 1 (Qëllimi)***

Autoriteti Kontraktues dhe Operatori Ekonomik kanë vepruar në mënyrë që dëmton parimet dhe objektivat e ligjit për prokurimin publik AK ka favorizuar një ofertues në kundërshtim me konkurrencën e ndershme.

- ***Shkelje e nenit 7 (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi)***

Autoriteti Kontraktues ka favorizuar një Operator Ekonomik të caktuar, duke krijuar kushte diskriminuese për pjesëmarrësit e tjerë dhe duke cenuar barazinë e trajtimit në procesin e tenderimit

- ***Shkelje e nenit 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)***

Vlerësimi i ofertave nuk është kryer në përputhje me kriteret dhe rregullat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke çuar në shpalljen fitues të një oferte që nuk plotëson kushtet themelore të tenderit.

- ***Shkelje e nenit 56 (Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave)***

Procesi i përzgjedhjes së ofertuesve nuk është realizuar sipas standardeve të përcaktuara ligjërisht, duke cënuar transparencën dhe besueshmërinë e procedurës.

- ***Shkelje e nenit 57 (Sigurimi i Tenderit)***

Nuk është bërë sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Rregullat dhe Udhezuesi Operativ per Prokurimin Publik:

- *Shkelje e nenit 4 (Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit)*

Administrimi i procedurës së tenderit nga ana e Autoritetit Kontraktues është bërë në mënyrë të papërgjegjshme dhe jo të mbështetur në ligjshmërinë e kërkuar

- *Shkelje e nenit 26 (Kriteret e Përzgjedhjes)*

Kriteret përzgjedhëse nuk janë zbatuar në mënyrë të njëtrajtshme dhe të drejtpërdrejtë për të gjithë pjesëmarrësit, duke favorizuar një ofertues të caktuar.

- *Shkelje e nenit 39 (Sqarimi i Tenderëve)*

Tek tabela e shembujve" Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet te veproj ne përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 te LPP-se Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm 57).

Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik e ndryshuar dhe plotësuar me rregulloren Nr.002/2024 :

- *Shkelje e nenit 25 Kriteret e përzgjedhjes*
- *Shkelje e nenit Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve*
- *Neni 97 Shkeljet e rënda*

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga OE Sigal tek Autoriteti Kontraktues, shihet që me vetedije ka shkelur rregullat e prokurimit publik. Pra këtu kemi veprim të paligjëshëm me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit publik, duke përdorur vula të bëra me foto (shih Deklaratën nën Betim , dhe Dokumentin Lista e Kontratave dhe Referencave) , duke blerë sigurimin e tenderit në ora 3 të natës (shih Verifikimin e Polices së blerë tek KS Elsig) dhe duke aplikuar rreth ores 4 të mëngjesit. Të gjitha këto janë bërë me qëllim te krijimit të disavantazhit për OE tjerë kur dihet se cmimet e sigurimit TPL janë të njëjta për të gjitha Kompanite e sigurimeve ne Kosove dhe të cilat janë të aprovuara nga BQK (Banka Qëndrore e Kosoves).

ARSYETIMI

Kompania e Sigurimeve Dukagjini Sh.A si Operator Ekonomik është pjesëmarrës në tenderin me numër prokurimi TU-25-215-2-2-1,lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : Sigurimi i autobusëve dhe veturave zyrtare, dhe me rastin e shpalljes së njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 13.03.2025, shpallet fitues OE Sigal, i cili operator me rastin e aplikimit në këtë tender ka bërë disa shkelje të cilat bien ndesh me ligjet në Kosove, dhe Autoriteti Kontraktues duke mos bërë vlerësimin e tenderit sipas Ligjeve të aplikueshme shpall fitues këtë OE. Theksojmë që AK ka rekomanduar për kontratë OE i cili bie ndesh me nenet e cekura më lartë.
Autoriteti Kontraktues ka ngarkuar tenderin në platformen e prokurimi me dt.20.01.2025 ora 00:00 dhe me dt. 21.01.2025 në ora 00:00 është bërë publikimi i njoftimit për kontratë. Në po të njëjten datë pra me 21.01.2025 në ora 03:04 min të mengjesit dmth menjëhere pas publikimit, OE shkarkon dosjen e tenderit, e plotëson dhe blenë sigurimin tek KS Elsig në ora 03:24, dhe aplikon në tender në orët e hershme të mëngjesit saktësishtë në ora 04:08min.

Duke ditur që në këtë tender një ndër kushtet ka qenë edhe sigurimi i tenderit shtrohet pyetja se si OE ka blere sigurimin tek kompania Elsig në ora 03:24min (Bashkangjitur gjeni verifikimit e polices së blerë tek KS Elsig polica me nr 135659) të datës 21.01.2025, kur dihet që orari zyrtar i kompanive të sigurimit është nga ora 08:00-16:00 dhe disa deri ne 17:00 me një kërkim të thjeshtë në google. Pra shihet qartë se Polica me nr 135659 është lëshuar jashtë orarit zyrtar gjë që shpie për shumë pikëpyetje për transparencen e këtij aktiviteti të prokurimit.
Nëse sigurimi është blerë një ditë më heret ku i morri informatat e tenderit OE si psh nr e prokurimit , shumën e siguruese të tenderit, validitetin etj., pra të gjitha të dhënat e sakta të aktivitetit të prokurimit, apo është bërë në bashkëpunim me ndonjë zyrtar të AK ku i ka siguruar të dhënat e këtij aktiviteti të prokurimit , informata të cilat janë në kundërshtim më shumë Ligje të aplikueshme në Kosovë përfshirë këtu edhe Ligjin e Prokurimit Publik.
Poashtu Garancioni i lëshuar nga KS Elsig nuk ka qenë për 90 ditë siq është kërkuar në dosje të tenderit mirëpo ka qenë më shumë se 90 ditë.
Edhe Periudha e vlefshmërisë se tenderit në dosje të tenderit është kërkuar që të jetë me validitet prej 60 ditëve ndërsa OE ka shënuar validitet prej 90 ditëve.

Shkelje tjeter e bërë nga OE Sigal janë edhe dokumentet e vulosura si: Deklarata nen Betim, dhe Lista e Kontratave dhe referencave, ku shihet qartë se këto dokumente nuk janë vulosur me vule origjinale dhe skenuar mirëpo janë bërë me pdf foto, ose programe tjera kompjuterike.
Pasi qe keto dokumenta nuk jane te vulosuara me vulen origjinale te kompanis, keto dokumenta jane jo valide.

Prandaj duke parë keto shkelje të bera nga Operatori ekonomik Sigal, Autoriteti Kontraktues është dashur që vleresimin e ofertave ta bëjë bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik dhe Ligjeve,rregulloreve, dhe udhëzimeve tjera të aplikueshme në Kosovë dhe OE ta eliminoj nga gara e jo ta shpërblej me kontrate pasi sic eshte cekur me larte shkeljet jane te renda. Pra kështu AK ka marr një vendim i cili është në kundërshtim me nenet e cekura më lartë.

Besojme qe Autoriteti kontraktues do ti merr perbazë keto fakte tonat dhe do te na shpall neve si fitues të këtij aktiviteti të prokurimit.

Përfundim

Marrja e një vendimi të padrejtë, në kundërshtim me vet Ligjet, dhe Rregulloret për Prokurimin Publik, sic e kemi cekur më lartë, dhe në kundërshtim edhe me Ligjet tjera të aplikuara në Kosovë, i ka shkaktuar, dhe vazhdon të na shkakojë dëme në emër të fitimit të humbur poashtu edhe uljen e Autoritetit në tregun e Sigurimeve.
Andaj,mbesim me shpresë që e drejta jonë të vendoset nga OSHP, bazuar në ligje, rregulloret edhe udhëzimet e aprovuara në Kosovë dhe të aprovojë ankesën si të bazuar në terësi, dhe të shpallemi ne fitues pasi plotësojmë të gjitha kriteret e parapara sipas dosjes të këtij tenderi.
Ritheksojmë që gjatë këtij aktiviteti të prokurimit është favorizuar një OE dhe kjo është në kundërshtim me LPP prandaj kërkojmë që ankesa jonë të aprovohet në terësi dhe të shpallemi fitues të ketij aktiviteti të prokurimit.

Me respekt,
KS DUKAGJINI SH.A.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompanisë sonë do të i shkakton dëme në emër të fitimit të humbur poashtu edhe uljen e Autoritetit në tregun e Sigurimeve.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura :

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. ***B05-Njoftimi per kontrat: 21.01.2025 00:00***
2. ***B12 - Proces verbali i hapjes se Tenderve: 10.02.2025***
3. ***B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues 13.03.2025***
4. ***Kërkesë për rishqyrtim : 18.03.2025***
5. ***Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim 19.03.2025***
6. ***Verifikimin e polices së blerë tek KS Elsig ku shihet ora e blerjes***
7. ***Deklarata nen Betim_Sigal_shih vulen***
8. ***Lista e kontratave dhe referencave SIGAL 2022 2024_Shih Vulen***
9. ***Sigurimi i tenderit***